



Kuvendi i Komunës së Deçanit

01.Nr.XII

Deçan, dt.19.09.2022

Bazuar në nenin 43.1 dhe nenin të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 39 të Statutit të Komunës së Deçanit, bëj këtë:

F T E S Ë



Ftoheni që të merrni pjesë në mbledhjen XII-të me radhë, gjegjësisht mbledhja e VIII-të e rregullt e Kuvendit të Komunës së Deçanit në vitin 2022.

Mbledhja do të mbahet me dt.28.09.2022, e mërkure, në ora 10:00, në Sallën e Kuvendit të Komunës.

Për mbledhje propozoj këtë:

Rend pune

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dt.30.06.2022 dhe nga mbledhja e dt.17.08.2022,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt-buxhetit për vitet 2023-2025,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores së Tatimit në pronë për vitin 2023 dhe marrja e Vendimit për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2023,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Model-Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet urbane,
5. Shqyrtimi i Model Rregullores për transportin public në teritorin e komunës së Deçanit,
6. Shqyrtimi i raportit 6 mujor të Kryetarit të Komunës,
7. Rishqyrtim i vendimeve me rekomandim të MAPL-së(Rishqyrtim i vendimit të dt.30.06.2022 për emërim të rrugëve, Rishqyrtim i Vendimit të dt.30.05.2022 për caktimin e lokacionit me destinim për varrezat e Lagjes Nuraj të fshatit Strellc i Ulët),
8. Shqyrtimi i raportit të Ndërmarrjes "Higjiena" për shumën prej 80.000€ të ndarë me vendim të Kuvendit të dt.28.02.2022,
9. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-Vendimit të Kryetarit të Komunës për themelimin e çmimit "Mirënjohje e qytetit",
10. Trajtimi i qenëve endacak,
11. Të ndryshme.



Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ



Drejtoria Për Mbrojtje, Shpëtim
Dhe Shërbime Publike

09 Nr. _____ /2022

Dt. 21 / 09 /2022

Për/To/Za :	Asamblenë Komunale në Deçan
CC :	
Përmes/Through/Preko :	Drejtorisë për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike
Nga/From/Od :	Drejtori z. Izet Zenuni
Tema/Subject/Subjekat	Kërkesë




Model rregullorja për Transportin Rugor në territorin e Komunës së Deçanit rregullon të gjitha fushat për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor të udhëtarëve dhe mallrave në territorin e Komunës së Deçanit (kombi busë, autobusë, taxi, transportin rrugor të mallrave etj), ku i qartëson detyrat dhe obligimet e komunës ,transportuesve dhe qytetarëve në bazë të Ligjit për Transport rrugor Nr.04/L-179

Kjo model rregullore i detajizon edhe masat ndëshkimore, obligimet e transportuesve dhe qytetarët të cilët e përdorin transportin publik.

Model rregullorja është e nevojshme që nësi komunë-drejtori këtë rregullore ta kemi në zbatim në mënyrë që operimi dhe funksionalizimi të jetë sa më efikas.

Model rregullorja implikon edhe drejtorit e tjera për zbatimin e saj e sidomos Drejtorin e Inspeksionit.

Kjo model rregullore do të nënshtrohet procedurave të diskutimit publik me palët e interesit, qytetarët dhe të gjitha ato kategori që implikohen në rregullore, me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, pushon të vlejë Rregullorja 01.Nr.VI-6, e datës 26.09.2014 mbi rregullimin e transportit Urban dhe Periferik të udhëtarëve në Komunën e Deçanit.





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Drejtoria për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike	Nr.09	/2022	Dt. / /2022
--	-------	-------	-------------

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika C të Ligjit nr. 031L — 040, për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 6, 7, 12 paragrafi 2, nenit 15, 17, 19, 25 dhe nenit 32 të ligjit për transport rrugor Nr.04L-179, dhe ne mbështetje të nenit 25 pika 1 të Statutit të Komunës së Deçanit, Kuvendi Komunal Deçan pas procedurës së diskutimit publik, miratoi këtë:

MODEL RREGULLORE

PËR TRANSPORTIN RRUGOR NË TERRITORIN E KOMUNËS SË DEÇANIT

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1.

Me këtë model rregullore përcaktohet ushtrimi i veprimtarisë së transportit rrugor të udhëtarëve dhe të mallrave në territorin e Komunës së Deçanit, lejimi ose ndalimi i përdorimit të kombi-busëve, autobusëve dhe taksi në rrugë të caktuara, marrja dhe zbritja e udhëtarëve dhe çështje të tjera lidhur me transportin e udhëtarëve, krijimi dhe mbajtja (ruajtja) e regjistrave dhe inspektimi i tyre, transporti i bagazhit të udhëtarëve ose i mallrave të tjera, rregullimi ose ndalimi i transportit të udhëtarëve që qëndrojnë në këmbë, çështja e mjeteve (të brendshme ose të jashtme) të autobusëve publik, pikat e stacioneve dhe vend ndaljet në linjat për autobusë, rregullimi i shpalljeve, shenjave dhe reklamave brenda apo jashtë autobusëve publik.

Përkufizime

Rrugë publike - një sipërfaqe me rëndësi të përgjithshme për komunikacion, në të cilën mund të lëvizë çdo kush me kushte të caktuara me ligj dhe të cilën organi kompetent e ka shpall rrugë publike;

Operator-taksi - veprimtari e transportit të udhëtarëve e cila ushtrohet nga personat fizik dhe juridik;

Stacion i autobusëve - Objekti me infrastrukturën përcjellëse të licencuar nga Ministria me qëllim të ofrimit të shërbime për operatorët e transportit rrugor të udhëtarëve dhe udhëtarët;

Vend-ndalje - sipërfaqe e ndërtuar dhe të shënuar posaçërisht, e caktuar për ndaljen e autobusëve e që mundëson hyrjen, përkatësisht daljen e sigurt të udhëtarëve dhe bagazheve;

Itinerar - akti i cili përcakton kahun e lëvizjes së automjeteve në linjë;

Lëshues i licencës - organi i cili sipas dispozitave të këtij ligji është kompetent për lëshimin e licencës;

Certifikatë e automjetit - dokument të cilin e lëshon organi kompetent për çdo automjet veç e veç dhe i cili përmban të dhënat për: lëshuesin e organit kompetent, operatorin e transportit, numrin e licencës, përkatësisht lejes, shenjën (targat) e regjistrimit, markën tipin, numrin e sasisë së automjetit, kapacitetin bartës, llojin e transportit që mund të kryhet, datën e lëshimit të certifikatës, vulën dhe nënshkrimin;

Operator i transportit rrugor të udhëtarëve - veprimtari e çdo operatori që vepron me anë të mjeteve motorike që janë të përshtatshme për bartjen e më shumë se nëntë personave, përfshirë edhe vozitësin, dhe të destinuara për këtë qëllim, shërbimet e transportit të pasagjerëve për publik ose për kategori të veçanta të përdoruesit në këmbim të pagesës nga personi i transportuar ose nga organizatori transportit;

Transport publik - transport të cilin në kushte të njëjta mund ta shfrytëzojnë të gjithë shfrytëzuesit e shërbimeve të transportit;

Transport publik linjor i udhëtarëve - transporti i cili kryhet në relacionet e caktuara dhe sipas rendit të udhëtimit, çmimeve dhe kushteve të përgjithshme të transportit të përcaktuara paraprakisht;

Licencë - akti me të cilin operatorit të transportit rrugor i lejohet të ushtrohet veprimtaria e transportit rrugor të udhëtarëve ose mallrave, stacionet e autobusëve dhe terminaleve të mallrave;

Linjë - relacioni ose tërësia e relacioneve të kryerjes së transportit në komunikacionin rrugor, prej stacionit fillestar deri në stacionin, përkatësisht deri në vend-ndaljen përfundimtare, në të cilën transportohen udhëtarët sipas rendit të udhëtimit të regjistruar dhe të publikuar me një ose me më shumë nisje;

Linjë urbane - linja e cila i lidh dy e më tepër stacione, gjegjësisht vend ndalje brenda kufijve urban të një Komune — qyteti;

Linjë urbane-periferike - linjë e cila i lidh dy e më tepër stacione, gjegjësisht vend ndalje brenda territorit të një Komune;

Linjë udhëtarësh - linjë në të cilën kryhet transporti ndërmjet stacionit fillestar dhe përfundimtar, përkatësisht vend ndaljes së autobusëve me ndalje të detyrueshme në të gjitha stacionet, përkatësisht vend ndaljet e autobusëve përgjatë rrugës së përcaktuar në rend të udhëtimit;

Linjë direkt - linjë në të cilën kryhet transporti ndërmjet stacionit fillestar dhe përfundimtar të autobusëve, përkatësisht të vend ndaljes së autobusëve, e përcaktuar në rend të udhëtimit pa u ndalur nëpër vend ndalje përgjatë rrugës;

Transport i veçantë linjor - transportin e vetëm një numri të caktuar të udhëtarëve i cili kryhet në bazë të kontratës me shkrim ndërmjet operatorit të transportit dhe porositisit të transportit, me ç ‘rast transportin e paguan porositisë;

Relacion - distancë ndërmjet dy vendeve të linjës të cilat në rend të udhëtimit janë shënuar si stacione të autobusëve, përkatësisht si vend ndalje të autobusëve;

Ndërprerja - çdo periudhë gjatë se cilës vozitësi nuk ka drejtë vozitjeje apo kryerje të ndonjë detyre tjetër, e qe i lejon vetëm pushim;

Rendi i udhëtimit - akt i cili përmban: emërtimin e operatorit të transportit, linjën në të cilën kryhet transporti, llojin e linjës, radhitjen e stacioneve të autobusëve, përkatësisht të vend ndaljeve të autobusëve, pastaj distancën nga vendi ku fillon linja, kohën e arritjes dhe të nisjes nga stacioni i autobusëve, përkatësisht në vend ndaljet e autobusëve, regjimin e mbajtjes së linjës, periudhën brenda të cilës mbahet linja dhe afatin e vlefshmërisë së rendit të udhëtimit;

Aparat i kontrollit - tahografi - aparati i destinuar që të jetë i instaluar brenda automjetit për të treguar dhe regjistruar në mënyrë automatike apo gjysmë automatike të dhënat mbi rrugëtimin e këtyre automjeteve dhe mbi disa, kohën e punës të ngasësve të tyre;

Neni 2

Rregullimin dhe organizimin e transportit rrugor të udhëtarëve dhe të mallrave në territorin e Komunës e bën Drejtoria për Shërbime Publike.

Neni 3

1. Kuvendi i Komunës së Deçanit, me propozim të Drejtorisë:
 - a. përcakton politikat e zhvillimit të shërbimeve të transportit të sigurt, efikas dhe ekonomik brenda territorit të komunës;
 - b. nxjerr Planin e Transportit dhe e ndryshon atë sipas nevojës;
 - c. ndryshon Planin e Transportit, jo më vonë se pesë vite nga data e nxjerrjes së tij;
 - d. publikon planin, apo planin e ndryshuar, dhe një kopje të tij ia dërgon Ministrisë kompetente për transport rrugor (në vazhdim "Ministria").
2. Planin duhet të jetë në përputhje me politikën e zhvillimit të tërësishëm të transportit në Kosovë.

Neni 4

Operatoret e transportit që kryejnë veprimtari transporti në territorin e komunës, janë të detyruar:

- a. të përdorin mjete të transportit që janë teknikisht në gjendje të rregullt;
- b. të mbajnë në mënyrë të rregullt regjistrin dhe dokumentet për çdo automjet për veprimtarinë e vet transportuese;
- c. të plotësojnë evidenca statistikore, sipas formave të miratuara nga organet përkatëse dhe ti raportojnë ato sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;
- d. të mbajnë dokumentet përkatëse në automjetet transportuese, të parapara sipas Ligjit për transportin rrugor.

Neni 5

Operatori i transportit, i cili bën transportin e rregullt publik, duhet të merr përsipër transportin e çdo udhëtarit apo malli, të cilat nuk janë të përjashtuar nga transporti sipas rregullave të veçanta.

Neni 6

Veprimtaria e transportit rrugor të udhëtarëve dhe mallrave, kryhet në bazë të licencës të lëshuar nga organi kompetent i Komunës së Deçanit

Neni 7

Dokumentacioni dhe kushtet për marrjen e licencës

1. Operatori i transportit publik të udhëtarëve nuk mund të ushtroj veprimtarinë pa u pajisur me leje dhe rend të udhëtimit, Rendi i udhëtimit lëshohet nga organi kompetent-drejtoria dhe vlen një vit me mundësi vazhdimi nëse operatori i është përmbajtur kushteve të licencës.

2. Licenca është akt me te cilin i lejohet operatorit ushtrimi i veprimtarisë së transportit të udhëtarëve në territorin e Komunës së Deçanit sipas kushteve të përcaktuara me ligjin për transportin rrugor dhe me këtë rregullore.

Licenca lëshohet në emër të operatorit dhe nuk mund të bartet të personat e tretë.

3. Licenca është e domosdoshme për:
 - a. transportin e rregullt të udhëtarëve;
 - b. transportin taksi të udhëtarëve;
 - c. transportin e mallrave dhe
 - d. терминаlet e mallrave (stacionet e ngarkesave).

Operatorët për marrjen e licencës duhet të i bashkëngjisin dokumentacionit si vijon :

- a. Të jetë i regjistruar për ushtrimin e veprimtarisë së transportit të udhëtarëve në automjete-taksi;
 - b. Fotokopjen e vërtetuar të certifikatës mbi regjistrimin e biznesit;
 - c. Fotokopjen e vërtetuar të certifikatës mbi regjistrimin e automjetit;
 - d. Për drejtuesit e automjeteve fotokopjen e vërtetuar të patentë shoferit, për kategorinë B-D;
 - e. Dëshminë nga gjykata se operatorit nuk i është shqiptuar masë mbrojtëse e ndalimit të kryerjes së transportit të udhëtarëve;
 - f. Dëshminë nga gjykata se drejtuesit të automjetit nuk i është shqiptuar masa mbrojtëse e ndalimit të drejtimit të automjeteve.
4. Licenca nuk është e nevojshme për automjetet e ndihmës së shpejtë, zjarrfikësve etj.

TRANSPORTI RRUGOR I UDHËTARËVE

Neni 8

1. Transporti rrugor i udhëtarëve në territorin e komunës ushtrohet si:
 - a. transport urban i rregullt i udhëtarëve me autobusë;
 - b. transporti i lirë i udhëtarëve;
 - c. transporti taksi i udhëtarëve dhe
 - d. transporti për nevoja personale.
2. Drejtoria është përgjegjëse për koordinimin dhe rregullimin e transportit urban të rregullt të udhëtarëve me autobusë dhe transportin taksi të udhëtarëve .

Neni 9

1. Transporti i rregullt i udhëtarëve me autobusë kryhet në relacione të caktuara (linja), sipas rendit të udhëtimit, të përcaktuar dhe të vërtetuar më parë, çmimit të caktuar të shpallur dhe kushteve të tjera të transportit;
2. Linjat të cilat lidhin dy e më tepër vendbanime në territorin e komunës, janë linja komunale.

Neni 10

1. Kuvendi miraton rrjetin e linjave urbane.
2. Komuna, përmes Kryetarit të Komunës, mund të lidhë marrëveshje me komunat tjera për rregullimin reciprok të transportit të udhëtarëve. Marrëveshja është e plotfuqishme nëse miratohet nga Ministria.

Neni 11

1. Me rendin e udhëtimit përcaktohen elementet për ushtrimin e veprimtarisë së transportit të rregullt në transportin rrugor në territorin e komunës, i cili përmban:
 - a. emërtimin e transportuesit;
 - b. relacionin;
 - c. llojin e transportit;
 - d. radhitjen e vend ndaljeve dhe largësinë e tyre nga pika fillestare;
 - e. kohen e nisjes dhe kohen e arritjes në çdo stacion dhe vend ndalje;
 - f. periudhën kohore në të cilën mbahet linja;
 - g. afatin e vlefshmërisë së rendit të udhëtimit.

Neni 12

1. Komuna ka kompetencë të certifikoj automjetet me më shumë se 8+1 ulëse për transportin urban dhe urbano-periferik;
2. Transportuesi është i obliguar që transportin ta kryejë në mënyrë të rregullt dhe sipas rendit të udhëtimit, të vërtetuar dhe të regjistruar në Drejtori.

Neni 13

1. Transportuesi obligohet që ta fillojë veprimtarin e transportit të rregullt urban të udhëtarëve në afat prej 3 ditësh nga dita e fuqizimit të rendit të udhëtimit dhe atë nuk mund ta ndërpresë derisa të zgjatë afati i rendit të udhëtimit;
2. Përjashtimisht nga paragrafi I i këtij neni, transportuesi mund të ndërpres përkohësisht veprimtarinë, si rezultat i kushteve të jashtëzakonshme, të cilat pamundësojnë ushtrimin e veprimtarisë së transportit të rregullt urban;
3. Për ndërprerjen , nga paragrafi 2 i këtij neni, transportuesi është i obliguar që të bëjë kërkesë në Drejtori, e cila do të lëshojë vendim për pranim apo refuzim të kërkesës së transportuesit;
4. Pa lejen e Drejtorisë, transportuesi nuk mund ta ndërpresë (pezullojë) veprimtarinë e transportit të rregullt urban në linjë, sipas rendit të udhëtimit të regjistruar dhe të vërtetuar.

Neni 14

1. Transportuesi rendin e udhëtimit nuk mund ta tjetërsoj, e as ta japë me qira.
2. Transferimin e rendit të udhëtimit e bën vetëm Drejtoria.

3. Emri i transportuesit, i shënuar në rendin e udhëtimit, duhet të jetë i njëjtë me atë të shënuar në librezën e qarkullimit të autobusit dhe në dokumentet tjera përcjellëse të autobusit.

Neni 15

Revokimi dhe marrja e licencës

1. Drejtoria do të revokojë rendin e udhëtimit në kushtet kur:
 - a. në afat prej 3 dit nga ditësh e fuqizimit, nuk e fillon ushtrimin e veprimtarisë;
 - b. pa miratimin e Drejtorisë, nuk bën nisjen 3 herë brenda një muaji kalendarik;
 - c. pa miratimin e Drejtorisë, bën ndërprerje të kohëpaskohshme të mbajtjes së nisjes, respektivisht kur 12 herë nuk mban nisjen brenda afatit të zgjatjes së rendit të udhëtimit,
2. Linjat dhe nisjet e revokuara do të konsiderohen si të lira dhe të njëjtat i nënshtrohen procedurës për ndarjen e tyre,
3. Operatori i Transportit është i obliguar që ndryshimin e rendit të udhëtimit dhe të drejtimit të transportit, ndaljen e përkohshme apo të përhershme të transportit në linjën e lejuar, paraprakisht të miratuar nga Drejtoria, ta shpallë përmes shtypit apo një mjeti tjetër të Informimit.

Neni 16

Çmimorja e Shërbimeve

1. Operatorët duhet të përcaktojnë çmimoren e shërbimeve të vërtetuar nga Drejtorati për Shërbime Publike;
2. Çmimorja duhet të përmbajë shënimet e operatorit komfor regjistrimit të biznesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit
3. Çmimorja aplikohet nga dita e vërtetimit nga Drejtorati i Shërbimeve Publike, e cila vendoset në automjetet afër taksi metrit në vend të përshtatshëm për tu lexuar nga udhëtarët;
4. Operatori për shërbimet e transportit duhet të i jap udhëtarit dëshmi mbi kryerjen e pagesës.

Neni 17

1. Transporti urban dhe urban-periferik i udhëtarëve në Komunën e Deçanit bëhet nga automjetet të cilat i përmbushin kriteret e përcaktuara me ligjin për transportin rrugorë dhe me këtë rregullore që nënkupton;
 - a. Automjetet me mbi 8+1 (autobus);
 - b. Auto-taksit me 4+1 ulëse me se paku 4 dyer, dhe motoçikleta 1+1.
2. Çdo udhëtar në kombi-bus, autobus dhe taksi duhet të pajiset me biletë, përveç personave me leje të veçantë të caktuar me ligj, Bileta blihet në autobus apo vende të tjera përkatëse, tek të cilat transportuesi ia ka besuar shitjen e tyre.

TRANSPORTI I VEÇANTË

Neni 18

1. Transport i veçantë i udhëtarëve është transporti i grupeve të caktuara të udhëtarëve, duke përfshiruar udhëtarët tjerë, në relacion të caktuar dhe në bazë të lejes së veçantë,
2. Më transport të veçantë të udhëtarëve kryhet transporti i:
 - a. nxënësve dhe studenteve nga vendbanimi deri te institucioni shkollor dhe anasjelltas;
 - b. Punëtorëve, nga vendbanimi deri në punë dhe anasjelltas.
3. Lejet për transport të veçantë, përmbajnë:
 - a. Relacionin;
 - b. listën e udhëtarëve;
 - c. çmimin e transportit, vendet për marrje dhe zbritje të udhëtarëve;
 - d. kohën, gjatë së cilës kryhet transporti.
4. Kontratën për kryerjen e transportit të veçantë e lidh transportuesi, i regjistruar si operator transporti, dhe porositiësi i shërbimeve për grupin e udhëtarëve;
5. Lejen për transport, sipas këtij neni, e lëshon Drejtoria për Mbrojtje Shpëtim dhe Shërbime Publike në Deçan, me pëlqimin paraprak të Kryetarit Komunës;
6. Në këndin e djathtë, të poshtëm, të xhamit mbrojtës të autobusit me të cilin kryhet transporti i udhëtarëve për nevoja personale, vendoset mbishkrimi "Transport i veçantë".

TRANSPORTI PËR NEVOJA PERSONALE

Neni 19

1. Operatori transportues, personi tjetër fizik/juridik dhe qytetari, i cili ka automjetin transportues, mund të kryejë transport për nevoja vetanake dhe transportin e punëtorëve të vet, ose personave të tjerë që kanë të bëjnë me kryerjen e veprimtarisë së vet, si dhe transportin e anëtarëve të familjeve të punëtorëve kur shkojnë në pushim apo rekreacion;
2. Transport i udhëtarëve për nevoja personale, në kuptim të kësaj rregulloreje, konsiderohet edhe transporti i personave, të cilin e bëjnë:
 - a. Ndërmarrjet hoteliere, personat tjerë juridik dhe fizik, të cilët kryejnë veprimtari hoteliere;
 - b. institucionet shëndetësore dhe ato të mbrojtjes sociale që bartin të sëmurit;
 - c. agjencitë turistike, personat tjerë juridik e fizik, të cilët kryejnë veprimtari turistike, dhe në bazë të kontratës së veçantë të transportit, transportojnë grupe turistësh pa pranimin dhe zbritjen e udhëtarëve gjatë rrugës;
 - d. shoqatat kulturore, sportive dhe shoqatat tjera që transportojnë nxënës, studentë, personel mësimor ose anëtarë të vet;

- e. auto shkollat, të cilat aftësojnë kandidatët për vozitës gjatë punës së tyre;
- f. operatorët transportues ose punëtorët, të cilët kryejnë shërbime të veçanta;
- g. operatorët për shërbime të aeroportit ose shoqatat tjera të shërbimeve të aeroportit, nëse kryejnë transportin e udhëtarëve nga vendnisja e tyre deri te aeroporti dhe anasjelltas.

Neni 20

1. Në autobusin me të cilin kryhet transporti për nevoja personale, duhet të jetë i plotësuar regjistri i punëtorëve ose i personave tjerë, i vërtetuar nga pronari (transportuesi);
2. Në këndin e djathtë, të poshtëm, të xhamit mbrojtës të autobusit me të cilin kryhet transporti i udhëtarëve për nevoja personale, vendoset mbishkrimi "Transport për nevoja personale".

KUSHTET PËR AUTOMJETET

Neni 21

1. Të gjithë automjetet me të cilët kryhet transporti publik urban i udhëtarëve, duhet të jenë të regjistruar dhe teknikisht në rregull, sipas dispozitave ligjore.
2. Automjeti me të cilin kryhet transporti publik urban, duhet të ketë:
 - a. firmën, respektivisht emërtimin e transportuesit, në pjesën anësore;
 - b. numrin e linjës me kohën e nisjes dhe kohën e arritjes ose intervalin e lëvizjes në stacionin e fundit, të vënë në këndin e poshtëm të djathtë të xhamit mbrojtës;
 - c. orarin e udhëtimit dhe çmimoren e transportit, të vendosura në vend të dukshëm, dhe mbishkrimin për ndalimin e pirjes së duhanit;
3. Automjeti duhet t'i plotësojë të gjitha kushtet higjieno—teknike të përcaktuara me ligj;
4. Kur automjetet nuk bëjnë transportin e rregullt të udhëtarëve, në këndin e majtë të xhamit mbrojtës vihet mbishkrimi përkatës "Garazh" apo "Defekt";
5. Gjatë sezonit të dimrit, para fillimit të punës në linjën e caktuar, automjeti duhet të ngrohet.

Neni 22

Në trafikun linjor transporti publik urban i udhëtarëve kryhet me linja të përhershme për çdo ditë dhe gjatë tërë vitit apo në periudhë të caktuar të vitit.

Neni 23

Linjat e transportit publik urban dhe urbano-periferik të udhëtarëve, hapen në përputhje me Planin e Transportit Lokal.

Neni 24

1. Hyrja dhe dalja e udhëtarëve behët vetëm në stacionet e autobusëve dhe në vend ndaljet e destinuara dhe të regjistruara në rendin e udhëtimit;

2. Transportuesi është i obliguar të ndalet në të gjitha vend ndaljet, të cilat i ka të regjistruara në rendin e udhëtimit.

Neni 25

Drejtoria e cakton numrin e stacioneve që janë të destinuara për kryerjen e shërbimeve të transportit urban.

Neni 26

Stacionet dhe vend ndaljet e autobusëve në linjat e përhershme me plan i cakton drejtoria.

Neni 27

1. Stacionet dhe vend ndaljet në linjat urbane dhe urbano-periferike duhet të jenë të rregulluara dhe të shënuara, doemos duhet të kenë sipërfaqe përkatëse të trafikut për ndaljen e automjetit, sipërfaqen për hyrjen dhe daljen e udhëtarëve dhe shenjat e stacionit;
2. Në rrugët publike, sipërfaqja për ndaljen e automjetit parimisht duhet të jetë e ndërtuar jashtë shiritit të rrugës, në pjesë të ndarë të rrugës;
3. Sipërfaqja që shfrytëzohet për hyrjen dhe daljen e udhëtarëve nga automjeti, në rrugë apo në vendbanim, duhet të jetë e shtruar me asfalt, pllaka ose të jetë e betonuar.

Neni 28

1. Për rregullimin e stacioneve dhe vend ndaljeve, mirëmbajtjen dhe vendosjen e shenjave, kujdeset Drejtoria;
2. Drejtoria mund të bëjë shpërndarjen ose transferin e stacionit dhe të vend ndaljes, nëse kjo është në interes të organizimit më të mirë dhe të sigurisë në trafik.

Neni 29

Stacioni apo vend ndalja në linjat në të cilat intervali i qarkullimit është më i gjatë se 15 minuta, duhet të ketë nen pullazet.

RREGULLSIA E AUTOMJETEVE

Neni 30

1. Automjetet me të cilat behët transporti rrugor i udhëtarëve dhe i mallrave në trafikun urban dhe urbano-periferik, duhet ti plotësojnë kushtet teknike dhe tekniko-shfrytëzuese të rregullsisë së automjeteve;
2. Automjetet duhet të kenë urdhëresë udhëtimit, të nënshkruar dhe të plotësuar në mënyrë të rregullt.

Neni 31

1. Çdo automjet në transportin rrugor të udhëtarëve në trafikun urban dhe urbano- periferik, duhet të jetë i pajisur me aparat zjarrfikës funksional, barnatore manual, çekiçi për thyerjen e xhamave në rast rreziku dhe pajisjet tjera;
2. Në pjesën e brendshme të automjeteve duhet të vendosen mbishkrimet e rëndësishme për rendin në automjet, ulëset për kategoritë e veçanta të udhëtarëve dhe shenjat e dymve të hyrjes dhe të daljes;
3. Në automjetet e transportit rrugor të udhëtarëve ndalohet vendosja e fotografive dhe objekteve të tjera me karakter diskriminues.

RENDI NË STACIONE, VENDNDALJA DHE VENDPARKINGJET

Neni 32

1. Automjetet patjetër duhet të ndalen në të gjitha stacionet, përkatësisht vend ndaljet e linjave të tyre;
2. Nëse automjeti nuk ka vende të lira, personeli i automjetit ka për detyrë t'i njoftoi udhëtarët për këtë;
3. Për kryerjen e veprimtarisë për bartjen e udhëtarëve në automjete komuna siguron dhe përcakton lokacionin për vend parkingjet dhe numri i automjeteve që mund të vendosen.
4. Për mirëmbajtjen e auto parkingjeve për automjetet e transportit të udhëtarëve kujdeset Drejtoria për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike.

Neni 33

1. Sinjalin për nisjen dhe ndaljen e automjetit e jep personeli i automjetit;
2. Vetëm personeli i automjetit hap dhe mbyll dyert e automjetit;
3. Personeli i automjetit nuk guxon të japë Shenjë për nisje, derisa të konstatohet se janë mbyllur dyert për hyrje dhe për dalje të udhëtarëve.

Neni 34

Personeli i automjetit ka për detyrë që gjatë orarit të punës të mbaj rrobat (uniformën) zyrtare dhe ndaj udhëtarëve të ketë sjellje korrekte.

Neni 35

1. Udhëtarët hyjnë në automjet përmes dymve të shënuara për hyrje dhe zbresin përmes dymve të shënuara për dalje;
2. Personat me aftësi të kufizuara fizike, gratë shtatzëna, personat me fëmijë deri në 5 vjeç, inspektorët e trafikut, policët në uniformë dhe personat me autorizime të veçanta, mund të hyjnë në dyert e daljes.

Neni 36

1. Për shfrytëzimin e shërbimeve të transportit, udhëtari duhet të ketë biletën e udhëtimit, biletën e parapagimit apo leje tjetër valide të udhëtimit;
2. Udhëtari është i obliguar që sipas kërkesës së personit të autorizuar, të tregojë biletën përkatëse të udhëtimit.

Neni 37

Transportuesi në trafikun publik urban dhe urbano-periferik të udhëtarëve, është i obliguar të japë biletën e udhëtimit, në bazë të së cilës udhëtari fiton të drejtën për udhëtim, si dhe biletën e bagazhit, nëse paguhet kompensim i veçantë për të.

Neni 38

1. Udhëtari i cili është gjetur, përkatësisht që gjendet pa biletë udhëtimi në automjet, është i obliguar që me kërkesë të personit të autorizuar, të bëjë kompensimin e biletës dhe gjobën në lartësi të dhjetëfishit të çmimit të biletës
2. Nëse udhëtari refuzon të bëjë pagesën, të përshkruar në paragrafin paraprak, detyrohet që personit të autorizuar i 'ia ofrojë të dhënat e sakta për identitetin e tij.

Neni 39

Drejtuesi i automjetit është i obliguar të respektojë itinerarin e linjës, të cilin duhet ta ketë në automjet.

Neni 40

1. Drejtuesi i automjetit në transportin linjor të udhëtarëve, nuk mund të ndalë parkojë automjetin në stacionin e nisjes më gjatë se 10 minuta.
2. Drejtuesi i automjetit nuk mund të nisë automjetin para se të ketë vërtetuar se janë mbyllur dyert e hyrjes dhe të daljes.
3. Derisa automjeti është në lëvizje, dyert patjetër duhet të jenë të mbyllura.

Neni 41

1. Udhëtari i cili dëmton apo e ndot automjetin, është i detyruar të kompensojë dëmin, përkatësisht të paguajë pastrimin e tij;
2. Nëse udhëtari refuzon ta bëjë kompensimin, përkatësisht pagesën sipas paragrafit paraprak, është i detyruar që personelit të automjetit t'ia ofrojë të dhënat e sakta për identitetin e tij.

Neni 42

1. Udhëtari mund të futë në automjet: bagazhin e dorës, karrocën e mbledhur të fëmijëve, pushkën e gjahut ose te sportit me këllëf, skitë dhe kompletin për peshkim;
2. Në automjet, në pjesën ndihmëse, mund të futen qentë zyrtarë dhe qentë ciceron të personave të verbër, me shportë në turi.

Neni 43

1. Gjërat e gjetura në automjet i dorëzohen personelit të automjetit, i cili për këtë lëshon vërtetim me përshkrimin e shkurtër të sendeve të gjetura. Nëse pronari i gjësendeve të

gjetura mik gjendet gjatë vozitjes, personeli i automjetit ato ia dorëzon menjëherë shërbimit përkatës të transportuesit;

2. Transportuesi detyrohet që gjësetet e gjetura, në afat prej 7 ditësh, t'ia dorëzojë policisë.

Neni 44

1. Në rast te ndërprerjes së trafikut apo prishjes së automjetit, personeli është i detyruar që udhëtarëve t'ua sigurojë daljen e sigurt nga automjeti;
2. Në rastet e prishjes së automjetit, nga paragrafi paraprak, transportuesi ka për obligim që udhëtarëve t'ua mundësojë vazhdimin e udhëtimit me automjet tjetër me të njëjtat bileta.

Neni 45

1. Gjatë transportit, ndalohet:
 - a. pengimi i personelit të automjetit në kryerjen e detyrës;
 - b. pirja e duhanit në automjet;
 - c. futja e kafshëve në automjet, përveç në rastet nga neni 42 i kësaj rregulloreje;
 - d. hyrja në automjet me armë, përveç personave të autorizuar;
 - e. futja në automjet e gjësendeve, të cilat mund të lëndojnë, dëmtojnë, ndotin, shqetësojnë udhëtarët ose dëmtojnë automjetin;
 - f. futja në automjet e materialeve ndezëse dhe mjeteve eksplozive;
 - g. hyrja në automjet në gjendje të dehur;
 - h. shqetësimi i udhëtarëve me këndim, me muzikë, me britmë, me shprehje e sjellje të papërgjegjshme;
 - i. hedhja e mbeturinave dhe pështymja në automjet;
 - j. hyrja në automjet në kundërshtim me nenin 33.1 të kësaj rregulloreje;
 - k. hyrja në automjet pas vërejtjes së personelit se nuk ka vende të lira.

Udhëtari i cili edhe pas vërejtjes, kryen ndonjërin nga veprimet e cekura në këtë nen, largohet nga automjeti,

TRANSPORTI RRUGOR I MALLRAVE

Neni 46

1. Transporti rrugor i mallrave më poshtë i quajtur: transporti i mallrave kryhet si:
 - a. transporti i mallrave për nevoja personale dhe
 - b. transporti i mallrave me qira dhe pagesë.
2. Gjatë transportit të mallrave, operatori në automjet duhet t'i ketë këto dokumente:
 - a. licencën ;
 - b. fletëngarkesën.

TRANSPORTI I MALLRAVE PËR NEVOJA PERSONALE

Neni 47

1. Ndalohe marrja me transport për nevoja personale, pa qenë i regjistruar si transportues për këtë;
2. Dispozita e pikës paraprake nuk do të zbatohet mbi mbajtësin e licencës për transport të mallrave me qira.

Neni 48

1. Emri dhe natyra e biznesit duhet të deklarohen kur të regjistrohet veprimtaria e transportit të mallrave për nevoja personale;
2. Regjistrimi nuk do të jetë i efektshëm derisa aplikuesi të tregojë se transporti i mallrave për të cilin është kërkuar regjistrimi, mund të emërohet si transport i mallrave për nevoja personale.

Neni 49

1. Me rastin e kryerjes së transportit për nevoja personale me automjet nga 3.5 deri në 12 tonelata të një mase më të madhe të lejuar, në automjet duhet të ketë:
 - a. fletëngarkesën dhe
 - b. dëshminë, me të cilën mund të vërtetohet se është fjala për transportin e mallrave për nevoja personale.

TRANSPORTI I MALLRAVE ME QIRA DHE PAGESË

Neni 50

1. Transporti i mallrave me qira dhe pagesë kryhet në bazë të Kontratës së lidhur në mes të qiradhënësit të automjetit transportues dhe qiramarrësit, i cili kontraktin transportin e mallrave,
2. Gjatë transportit të mallrave me qira dhe pagesë, operatori i transportit në automjet duhet të ketë:
 - a. fletëngarkesën dhe
 - b. kontratën në mes të qiramarrësit dhe qiradhënësit.

MBIKËQYRJA

Neni 51

1. Mbikëqyrjen në transportin rrugor urban dhe urban periferik brenda territorit të komunës, e bën Drejtoria për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike.
2. Inspeksioni i trafikut rrugor është i autorizuar:
 - a. të bëjë kontrollin e operatorëve të transportit rrugor për ushtrimin e kësaj veprimtarie në pajtim me dispozitat e kësaj rregulloreje, në bazë të licencave dhe lejeve, të

vërtetohet identitetin e operatorit transportues, personelit vozitës dhe të personave të tjerë përgjegjës për kryerjen e transportit;

- b. të urdhërojnë mënjanimin e lëshimeve dhe mungesave në aspektin e plotësimit të kushteve të përcaktuara me këtë rregullore për kryerjen e transportit të udhëtarëve dhe të mallrave;
 - c. të përjashtojë nga qarkullimi automjetin, me të cilin kryhet transporti në kundërshtim me dispozitat e ligjit dhe të kësaj rregulloreje, të caktoj vend parkimin, t'ia marrë lejen e qarkullimit dhe targat në kohëzgjatje prej 48 orësh;
3. Nëse të njëjti operator të transportit i shqiptohet masa e gjobës mandatore për herë të dytë, për shkaqet e përcaktuara në paragrafin 2, pika C të këtij neni, automjeti do të përjashtohet nga qarkullimi në kohëzgjatje deri në 5 ditë;
 4. Me rastin e përjashtimit të automjetit taksi, atij i merret shenja "TAXI" - "RADIO TAXI" dhe numri i evidencës i regjistrimit të qarkullimit;
 5. Me kalimin e afatit të masës, nga paragrafi 2, pika C dhe paragrafi 3 i këtij neni, inspektori ia kthen operatorit dokumentet dhe targat e marra, qoftë vetë apo përmes organit i cili ka lëshuar këto.

Neni 52

Kur inspektori përjashton automjetin nga qarkullimi, merr vendim që automjeti i ndaluar të dërgohet, në shpenzime të mbajtësit të licencës, në vende të caktuara për këto raste.

Neni 53

1. Kundër vendimit të inspektorit të trafikut rrugor mund të ushtrohet kërkesë për rishqyrtimin e vendimit apo ankesë Ministrisë, në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së vendimit.
2. Kërkesa për rishqyrtimin e vendimit i dërgohet Drejtorisë për punët e inspektionit = Sektorit të Inspektionit të transportit rrugor, kurse ankesa i dërgohet drejtpërdrejt Ministrisë.
3. Ankesa nuk e shtyn ekzekutimin e vendimit.

MASAT NDËRSHKUESE

Neni 54

1. Me gjobë prej 500 deri në 2.500 euro, dënohet operatorit transportues, përkatësisht personi tjetër juridik apo fizik për kundërvajtje, në qoftë se:
 - a. ushtron veprimtarinë e transportit publik urban pa licencë (neni 6);
 - b. ushtron veprimtarinë e transportit publik të udhëtarëve pa licencë dhe rend të udhëtimit (neni 8);
2. Nëse operatori i transportit, përkatësisht personi tjetër juridik apo fizik bën përsëritje të kundërvajtjes së njëjtë, përveç dënimit me gjobë, do t'i shqiptohet edhe masa mbrojtëse

e ndalesës së ushtrimit të veprimtarisë së transportit në kohëzgjatje prej 6 deri në 12 muaj.

Neni 55

1. Me gjobë prej 500 deri në 2.500 euro dënohet operatori i transportit, përkatësisht personi tjetër juridik, në qoftë se:
 - a. nuk mban linjën sipas rendit të udhëtimit, të vërtetuar dhe të regjistruar (neni 12);
 - b. ndryshon rendin e udhëtimit, ndërpret përkohësisht transportin dhe nuk e paraqet ndërprerjen (neni 13.1 dhe 13,3);
 - c. nëse nuk përcakton çmimoren dhe nuk e vendos atë në autobus apo nuk i përmbahet asaj (neni 16);
 - d. bën transportin e veçantë të udhëtarëve në kundërshtim me nenin 18;
 - e. bën transport për nevoja personale në kundërshtim me nenin 19;
 - f. vepron në kundërshtim me nenin 14, I;
 - g. vepron në kundërshtim me nenin 20;
 - h. vepron në kundërshtim me nenin 36. I;
 - i. vepron në kundërshtim me nenin 47. I;
 - j. vepron në kundërshtim me nenin 49;
 - k. vepron në kundërshtim me nenin 50.
2. Për kundërvajtje të njëjta që transportuesi përkatësisht personi juridik apo fizik i përsërit, përveç dënimit me gjobë, do t'i shqiptohet edhe masa mbrojtëse e ndalesës së ushtrimit të veprimtarisë së transportit, në kohëzgjatje prej 6 deri në 12 muaj.

Neni 56

1. Operatori i transportit mund të dënohet me gjobë prej 150 deri në 300 euro:
 - a. nëse personelit të vozitjes nuk ia siguron rrobat (uniformën) zyrtare (neni 34);
 - b. nëse nuk vepron sipas dispozitës së nenit 20.
2. Në rast kundërvajtjeje nga pika I e këtij neni, dënohet edhe personi përgjegjës i operatorit të transportit, me gjobë prej 75 deri në 120 €.

Neni 57

1. Operatori i transportit dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej 150 deri në 500 €:
 - a. nëse kryen transportin me automjete, të cilat nuk i plotësojnë kushtet nga neni 31;
 - b. nëse nuk vepron sipas dispozitës së nenit 32;
 - c. nëse nuk ia jep biletën udhëtarit (neni 37);
 - d. nëse kryen transportin e personave, të mallrave apo të kafshëve, në kundërshtim me nenin 44;
 - e. nëse nuk vepron sipas dispozitës së nenit 43.

2. Në rast kundërvajtje nga pika I e këtij neni, dënohet edhe personi përgjegjës i operatorit të transportit, me gjobë prej 75 deri në 120 €

Neni 58

Udhëheqësi i ekipit të automjetit dënohet për kundërvajtje, me gjobë mandatore prej 50 €, nëse vepron në kundërshtim me nenin 31, paragrafi 2 dhe nenet: 32, 33 dhe 34.

Neni 59

Transportuesi dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej 100 deri në 300 €, nëse vepron në kundërshtim me nenin 21.

Neni 60

Udhëtari dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej 50 deri në 100 €, nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e neneve: 36, 38, 41, 42 dhe 45.

Neni 61

Dënimet mandatore për kundërvajtje i shqipton inspektori i komunikacionit.

Procedura e ankesave

Neni 62

Pala e pakënaqur me vendimet e bazuar në këtë rregullore të Drejtorisë për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike mund të parashtrij ankesë për rishqyrtim të vendimit të drejtorisë, përkatësisht të Inspektori i Trafikut, apo departamentit të ankesave pranë Ministrisë së Infrastrukturës në afat prej 30 ditësh nga dita e njoftimit me vendim.

DISPOZITAT KALIMTARE, SHFUQIZUESE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 63

Operatorët e transportit obligohen që, në afat prej 6 muajsh prej ditës së hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, të bëjnë harmonizimin e akteve të tyre me dispozitat e kësaj rregulloreje.

Neni 64

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, pushon të vlejë Rregullorja 01.Nr.VI-6, e datës 26.09.2014 mbi rregullimin e transportit Urban dhe Periferik të udhëtarëve në Komunën e Deçanit.

Neni 65

Rregullorja hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë Përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale, si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Deçan dt.28.09.2022

KRYESUESI I KUVENDIT
Hajdar Sutaj
